



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Zyra për Komunikim me Publikun
Kancelarija za Javno Komuniciranje
Office of Public Communication

THIRRJE PËR APLIKIM

Për Pagesa Direkte për kulturat bujqësore (misër, luledielli dhe farë gruri) për vitin 2013

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural edhe këtë vit do të mbështes mbjelljen pranverore të misrit, lulediellit dhe farës së grurit për përmes pagesave direkte për njësi të sipërfaqes së mbjellë. Niveli i mbështetjes planifikohet të jetë 100 euro/ha për misër dhe luledielli, ndërsa 200 euro/ha për farë gruri.

Fermerët që aplikojnë duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë mbjellë së paku 1 ha tokë me misër në pronësi;
- Të kenë mbjellë së paku 1 ha tokë me luledielli në pronësi;
- Të kenë mbjellë minimum 5 ha dhe maksimum 100 ha me grurë për prodhimin e farës së grurit;
- Parcela e mbjellë me misër ose luledielli, duhet të jetë në minimum 0.20 ha e pandarë;
- Parcela e mbjellë me grurë për prodhimin e farës së grurit, duhet të jetë në minimum 1 ha e pandarë;
- Fara e mbjellur e grurit duhet të jetë në Listën e Lejuar të Farës;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira, duhet të jetë e kontraktuar së paku për një vit;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira duhet të jetë 1 ha e pandarë;
- Sipërfaqet e mbjella me grurë për farë duhen plotësuar kriteret gjatë inspektimit fushor.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Aplikacioni i plotësuar;
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Kopja e kartelës së xhirollogarisë bankare valide;
- Dëshminë nga kadastra për sipërfaqen e tokës së punueshme ose kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmëri të tokës bujqësore;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit (për personat juridik);
- Kontrata për sipërfaqen e marr me qira, duke bashkangjitur fletën poseduese të qiradhënësit;
- Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
- Dëshminë mbi kategorinë e farës së mbjellur për farë gruri;
- Kontratën me kompaninë prodhuese të farës (vetëm fermerët që aplikojnë për pagesa direkte për farë gruri);
- Formularin për sipërfaqet e mbjellura për farë gruri (e verifikuar nga MBPZHR, vetëm fermerët që aplikojnë për pagesa direkte për farë gruri).
- Dëshminë për sasinë e grurit të dorëzuar kompanisë prodhuese të farës (t'i bashkëngjitet dokumentacionit pas korrjes së grurit).

Periudha e aplikimit:

Aplikimi zgjatë 45 ditë kalendarike dhe fillon prej momentit të shpalljes publike.

Aplikimi bëhet në zyrat e Drejtorive Komunale për Bujqësi përmes programit sLPIS.

Mënyra e aplikimit:

Të gjithë fermerët fillimisht, gjatë aplikimit janë të obliguar të plotësojnë formularin për regjistrim në Regjistrin e fermerëve, i cili është parakusht për përfitimin e mbështetjes.

Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve do të aplikohen masa ndëshkimore, duke u bazuar në nenin 30 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për pagesat direkte në lëmin e bujqësisë.

Sqarim:

Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet në dy kopje dhe brenda periudhës së aplikimit. Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.